



KREMTIMI I KOHËS SË KRIJIMIT 2020

MESAZHI I ATIT TË SHENJTË FRANÇESKUT PËR KREMTIMIN E DITËS VI BOTËRORE TË LUTJES PËR KUJDESHIN NDAJ KRIJIMIT

Të dashur vëllezër e motra,

Çdo vit, veçanërisht që prej botimit të Letrës enciklike Laudato si' (LS, 24 maj 2015), dita e parë e shtatorit shënon për familjen e krishterë Ditën Botërore të Lutjes për Kujdesin ndaj Krijimit, me të cilën fillon Koha e Krijimit, që përfundon më 4 tetor, në përkujtimin e shën Françeskut të Asizit. Në këtë periudhë, të krishterët në të gjithë botën përtërijnë fenë në Hyjin krijues dhe bashkohen në mënyrë të veçantë në lutje dhe në veprim për mbrojtjen e shtëpisë së përbashkët.

Jam i lumtur që tema e zgjedhur prej familjes ekumenike për kremtimin e Kohës së Krijimit 2020 është "Jubile për Tokën", pikërisht në vitin në të cilin i bie 50-vjetori i Ditës së Tokës.

Në Shkrimin e Shenjtë, Jubileu është koha e shenjtë për të kujtuar, për t'u kthyer, për të pushuar, për të ndrequr dhe për t'u gëzuar.

Teksti i plotë: ofm.org

FRANÇESKANËT BASHKOHEN PËR TË KREMTUAR "KOHËN E KRIJIMIT"

Ka filluar Koha e Krijimit: nga 1 shtatori me kremtimin e Ditës Botërore të Lutjes për Kujdesin ndaj Botës së Krijuar deri më 4 tetor, festa e Shën Françeskut të Asizit, pajtorit të mbështetësve të ekologjisë. Shumë të krishterë bashkohen në këtë moment të veçantë për të reflektuar, për t'u lutur dhe për të bërë veprime konkrete që i lejojnë njerëzimit të jetojë një stil jete që në solidaritet kujdeset për shtëpinë e përbashkët.

Teksti i plotë: ofm.org

RAP PËR NJË KTHIM EKOLOGJIK, "LAUDATO SI' REVOLUTION"

Më 1 shtator 2020 ka qenë Dita Botërore e lutjes për mbrojtjen e Krijimit dhe dita e parë e Kohës së Krijimit. Si pjesë e Revolucionit Laudato Si', një fushatë françeskane globale për kthimin ekologjik të tërësishëm, zyra DPIK e ka kremtuar këtë ditë me RAP: "Laudato Si' Revolution", projekt i filluar kohët e fundit nga fra Sandesh Manuel OFM.

Teksti i plotë: ofm.org

LAJME TË TJERA



Panele të reja diellore në famullinë Mission San Luis Rey (Kaliforni, SHBA)

Më 11 gusht 2020, atë Oscar Méndez OFM, famullitar i famullisë Mission San Luis Rey në Kaliforni, SHBA, ka bekuar panelet e reja diellore të famullisë. Ka qenë e rëndësishme që kjo të bëhet në festën e Shenjtes Kjara, emri i së cilës në italisht do të thotë "dritë". Kohëzgjatja e projektit ka kërkuar pak më shumë se një vit. Pas miratimit të tij, më në fund është realizuar ndërtimi i vërtetë.

Që prej Shën Françeskut te Papa Françesku e te Ipeshkvi i San Diegos Robert McElroy, të gjithë na ftojnë të kujdesemi për shtëpinë tonë të përbashkët. Panelet diellore do të kenë një ndikim domethënës në pakësimin e ndotjes së famullisë. Në 25 vitet e ardhshme panelet diellore do të bëjnë që të kursehen rreth 253.000 kg CO2 i lëshuar në atmosferë, do të pakësojnë gazrat serë të barabarta me një plantacion prej 602.982 m2 pemësh dhe do të bëjnë që të kursehen 64.389 litra vajguri energji të prodhuar nga lëndët djegëse.

Natyrisht, ka edhe kursime të ndjeshme financiare. Në vitin e parë, kursimi i parashikuar sillet rreth 20.000 dhe 25.000 dollarëve, me një total prej 1,1 milionë dollarë në 25 vjet. Gjithashtu, këto panele krijojnë edhe një hije të bukur në parkingun e kishës.




Hapet Mini shop-i françeskan i Fretërve Minorë të Pulias dhe Molizes

Bazilika Zoja e Martirëve në Molfeta. Më 4 shtator 2020, gjatë kremtimit eukaristik të orës 19:00, të drejtuar nga Ministri provincial fra Alessandro Mastromatteo, u përrua "Mini shop-i françeskan", emporiumi solidar i Fretërve Minorë të Pulias dhe Molizes. Në vendin e bashkëndarjes me më nevojtarët, gjenden prodhime, kryesisht ushqimore, të vëna në dispozicion nga firma të ndryshme të krahinës sonë të cilat veprojnë në sektorin ushqimor. "Mini shop-i", ka theksuar Ministri, "nuk do të jetë një veprimtari tregtare, por thjesht një vend ku do të jetohej dashuria e krishterë në mënyrë të ndryshme, duke u ridhënë dinjitet, nëpërmjet mundësisë së zgjedhjes, atyre që janë në nevojë". Gjithashtu, gjatë përrimit, fra Alessandro uroi që ky projekt pilot i Provincës së "Shën Mëhillit Kryeengjell" të mund të zhvillohet shpejt edhe pranë kuvendeve të tjera të Fretërve Minorë të Pulias dhe Molizes.

Përkthime të plota në anglisht të Burimeve të Para Françeskane tani Online

Më 31 gusht 2020, Komisioni për Franciscan Intellectual Tradition (KTIF - Komisioni për Traditën Intelektuale Françeskane) ka lajmëruar publikimin e plotë në sitin e vet web të serisë klasike në tri vëllime mbi jetën dhe misionin e Shën Françeskut: Françesku i Asizit, Dokumentet e Para; po ashtu edhe një vëllim përplotësues: Kjara e Asizit, Dokumentet e Para.

Hartimi origjinal në letër i burimeve të para mbi lëvizjen françeskane, i publikuar mes viteve 1999 dhe 2001, është bërë prej studiuesve



franceskanë Regis J. Armstrong, OFM Cap.; J. A. Wayne Hellmann, OFM Konv. dhe William J. Short, OFM. Një vëllim i dytë i ndarë, Kjara e Asizit, Dokumentet e Para, nën kujdesin e Regis J. Armstrong, OFM Cap., është publikuar në vitin 2006. Përveç këtyre përkthimeve, në dobi të kërkuësve dhe studentëve versioni online përfshin edhe tekstet origjinale në latinisht.

Me shkrimet e plota të Françeskut dhe Kjarës së Asizit dhe dëshmitarët e parë të jetës së tyre, shërbesën dhe kanonizimin, siti Web mund të konsultohet nga studentë, kërkuës dhe dashamirës të jetës françeskane duke shkuar në adresën e KTIF: www.franciscantradition.org.

Papa Françesku do të shkojë në Asizi për të firmosur Enciklikën e re "Të gjithë vëllezër" mbi vëllazërinë dhe miqësinë shoqërore


Pasditen e së shtunës 3 tetor 2020 Ati i Shenjtë Françesku do të shkojë në Asizi për të firmosur Enciklikën e re "Të gjithë vëllezër" mbi vëllazërinë dhe miqësinë shoqërore.

Prefektura e Shtëpisë Papnore informon se në orën 15:00 Ati i Shenjtë do të arrijë në Kuvendin e Shenjtë, ku do të kremtojë Meshën e Shenjtë pranë Varrit të Shën Françeskut, dhe në përfundim do të firmosë enciklikën.

Burimi: press.vatican.va




BOTIME TË REJA FRANÇESKANE



GERARD THOMAS STRAUB OFS,
The Sunrise of the Soul: Meditations on Prayerful Stillness, Silence, Solitude, and Service in the Spirit of St. Francis of Assisi [Meditime mbi qetësinë, heshtjen, vetminë, shërbimin lutës në shpirtin e Shën Françeskut të Asizit], Paraclete Press, Orleans 2020, fq. 256.

Ky libër është fryt i 24 viteve të fundit të një jete të re e të papritur, të një rrugëtimi shndërrues që e kanë çuar Straubin nga mondaniteti i Hollywood-it në llahtararin e lagjeve më të këqija të tokës. Ky udhëtim filloi në një kishë të Romës, të zbrazët, gjatë një momenti hiri në të cilin një shkëndijë drite depërtoi koracën e fortë të ateizmit të tij të zjarrtë, duke i lejuar të shohë se Hyji ishte i vërtetë dhe se e donte ashtu si ishte. Në fund, Straubi perceptoi se Hyji ishte duke i thënë që të mos i filmonte më të varfrit dhe të shkonte të jetonte mes të varfërve. Tani jeton në një lagje të varfër e të madhe të Haitit, ku drejton një shtëpi shprese dhe shërimi për 69 fëmijë të braktisur. Pas më shumë se katër vitesh pune të madhe në Haiti, ka filluar t'i kushtohet fuqisë përtëritëse të vetmisë së njëmendtë duke u bërë i vëmendshëm ndaj varfërisë së vet shpirtërore të brendshme. Në heshtjen e errësirës që i paraprin agimit të çdo mëngjesi në Haiti, ai pret, reflekton dhe lutet. Ky libër ka lindur dalëngadalë prej këtyre orëve të shumta të vetmisë në heshtje.



DAVID COUTURIER OFMCAP,
The Voice of Victims, The Voice of the Crucified: A Franciscan Perspective (Zëri i Viktimave, Zëri i të Kryqëzuarit: Një Perspektivë Françeskane), Franciscan Institute Publications, St. Bonaventure 2019, fq. 127.

Ky është një libër për të gjithë ata që janë të llahtaritur e të zhgënjyer prej krizës së abuzimeve në Kishën Katolike. Fillon duke përshkruar mënyrën me të cilën Kisha ka krijuar një kulturë të mizorisë e korrupsionit dhe pastaj zhvillon një themel teologjik e shpirtëror për shpresën dhe ndryshimin. Ky tekst bazohet në përshpirtërinë e Shën Françeskut dhe Shenjtes Kjara të Asizit për të treguar një ecje reforme, përtëritjeje dhe rimarrjeje.

MINISTRAT E RINJ PROVINCIALË


Fra Anthony Chircop
Provinca e Shën Palit Apostull
Maltë

Fra Livio Crisci
Provinca e Shën Françeskut të Stigmatizuar
Itali

Fra Simone Giampieri
Provinca e Shën Jakobit të Markeve
Itali

Fra Kevin J. Mullen
Provinca e Emrit të Shenjtë të Jezusit
SHBA

Fra Ronald Walters
Provinca e Zojës së Guadalupe
SHBA



PAOLO EVANGELISTI,
Dopo Francesco, oltre il mito. I frati Minori tra Terra Santa ed Europa (XIII-XV secolo) [Pas Françeskut, përtej mitit. Fretërit Minorë mes Tokës së Shenjtë dhe Europës (shekujt XIII-XV)], Viella, Roma 2020, fq. 296.

Sapo ka përfunduar tetëqind-vjetori i takimit mes Françeskut të Asizit dhe nipit të Saladinit,

sulltanit Al-Malik al-Kamil, që ka ndodhur në shtator të vitit 1219, në një përpjekje për dialog që ka bërë të kapërcehen barrierat dhe kufijt. Pas atij takimi prania e Fretërve Minorë në Tokën e Shenjtë u zhvillua në shumë dimensione. Fretërit, duke zbatuar Rregullën e tyre, qenë protagonistë të një stine të fuqishme veprimi dhe mendimi që pati në qendër çështjen e ballafaqimit dhe të kthimit të mundshëm të infideles-ve në Përtejdetin kryqtar, që vazhdoi pas vitit 1291, kur ata menduan të pamendueshmen: të ishin përsëri në Jerusalemin tashmë në duart myslimane.

Mes Europës dhe Mesdheut fretërit u treguan diplomatë të zotët, predikues kryqëzate, rekrutues të aftë të përcaktonin profilet e luftëtarit të vërtetë për Krishtin, madje edhe vazhdues të projekteve të ripushtimit të Përtejdetit, njerëz që menduan dhe praktikuan dëshminë martiriale duke e rivendosur kuptimin e saj brenda asaj përvoje të gjatë historike që i bënte thirrje secilit prej tyre dhe gjithë Urdhrit të Fretërve Minorë.



Familja injaciane dhe familja françeskane ndihen të bashkuara, sidomos në kujdesin për dhuratat e krijimit, për shtëpinë e përbashkët dhe për ndërtimin e marrëdhënieve të drejta e respektuese.

Sikurse referojnë ata vetë, bashkimi i françeskanëve dhe jezuitëve bën pjesë në lëvizjen ndërkombëtare "Laudato Si Revolution" që ka një domethënie të madhe, sepse bashkon karizmat dhe forcat e dy shenjtërve të mëdhenj themelues – Françesku dhe Injaci – të cilët reflektohen në figurën e Papës Françesku, jezuit, që personifikon dy shenjtërit duke zgjedhur emrin Françesk.

Jezuitët dhe françeskanët, me këtë bashkim, propozojnë një "revolucion" që inkorporon një ndryshim të thellë të paradigmes në marrëdhënien me tokën, "shtëpinë e përbashkët" tonën; në mbrojtje të të varfërve dhe të të përjashtuarve, duke i konceptuar ata si bashkëbisedues dhe jo vetëm si destinatorë; në mbrojtje të popujve vendas dhe të pakicave të tjera; dhe, së fundi, në mbrojtje të demokracisë dhe kundër çdo lloj autoritarizmi.

Hollësitë e këtij rrugëtimi të ri janë shpallur në webinar që nga 30 shtatori 2020, në praninë e teologut Leonardo Boff dhe të teologes María Clara Bingemer, që kanë paraqitur, përkatësisht në bazë të përshtypjeve françeskane dhe injaciane, themelet frymëzuese të këtij takimi simbolik mes dy traditave.

Ndiqui nismat e ndryshme në faqen e tyre Facebook: facebook.com/revolucaolsbrasil

TETOR 2020

1-4

ASIZI

Kremtime dhe takime
mes ministrave gjeneralë
me rastin e
së Kremtes së Shën Françeskut.

5-24

ROMË

Përgatitja e Kapitullit gjeneral

21

ROMË

Antonianum:
Përurimi i Vitit akademik

26-31

ROMË

Kohë e Fortë



PARIS: PËRURIMI I EKSPOZITËS "GUARDIANËT E VARRIT TË KRISHTIT"

Çdo vit, më se dhjetë milionë turistë vizitojnë Bazilikën e Zembrës së Shenjtë të Parisit, vendi i dytë më i vizituar në Francë pas Katedrales Notre Dame. Ndërsa Zemra e Shenjtë mbyll jubileun e 100-vjetorit të shugurimit të Bazilikës, dyert e saj mirëpresin për herë të parë një ekspozitë për publikun e madh. Është ekspozuar një total prej njëzet e nëntë fotografish, të shkrepura nga Thomas Coex, kreu i departamentit fotografik të zyrës së shtypit të Agence France Presse të Jeruzalemit nga viti 2014 deri në vitin 2019.

Ekspozita "Guardianët e varrit të Krishtit" është falas dhe fotografitë do të rrinë të ekspozuara deri më 13 dhjetor 2020.

Për më shumë info: ofm.org | custodia.org